

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, në bazë të nenit 88 dhe nenit 39 paragrafi (4) të Ligjit për gjykatat, nenit 13 dhe nenit 112 nga Rregullorja gjyqësore dhe Rregullorja e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.14 të datës 20.01.2022), pas mendimit të dhënë paraprak për Orarin vjetor të punës së Gjykatës, nga Seanca e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të datës 21.12.2022, më 11.01.2023, miratoi këtë:

**ORAR VJETOR**  
**të punës së Kryetarit dhe gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të**  
**Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023**

**I**  
**ADMINISTRATA GJYQËSORE**

**A.I. Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi** do të udhëheq dhe menaxhojë me Gjykatën, do të organizojë punën e Gjykatës dhe do t'i realizojë punët nga pjesa e Administratës gjyqësore.

**Kryetarja e Gjykatës** do ti realizojë punët dhe detyrat punuese për të cilat është kompetente në pajtim me Ligjin për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06, 62/06, 35/08 dhe 150/10, 83/18, 198/18 dhe 96/19), Ligjit për Këshillin gjyqësor të RMV ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.102/19), Rregulloren gjyqësore, Rregulloren e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.14 të datës 20.01.2022), edhe atë:

- do të prezantojë Gjykatën,
- do të organizojë punën dhe do të ndërmerr masa për kryerjen në kohë dhe në rregull të punëve në Gjykatën dhe për sigurimin e zbatimit të Rregullore gjyqësore,
- do të veprojë për parashtresat, ankesat dhe propozimet e palëve dhe organeve tjera nga Regjistri UPP,
- do të veprojë për kërkesat për përjashtime të parashtruara nga gjyqtarët dhe nga palët nga Regjistri SU-IZZ,
- do të veprojë për lëndët nga regjistrat Su, Su01, Su03, Su04, Su05, Su-06, Su-DOV, Su-Str.Strog.DOV dhe
- do të udhëheq me Sektorin e veprave civile si Kryetare e Sektorit.

**A.II.** Për zëvendës të Kryetares së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut **Besa Ademi**, caktohet gjyqtarja **Cvetanka Periq**, e cila do ta zëvendësojë Kryetaren në mungesë të saj.

## ORGANIZIMI I GJYKATËS SIPAS SEKTORËVE

### II

#### SEKTORI I VEPRAVE PENALE

**B.I. Në Sektorin e veprave penale caktohen gjyqtarët:**

1. **Cvetanka Periq - Kryetare**
2. **Dr. Xhemali Saiti - anëtar**
3. **Afrim Fidani - anëtar**
4. **Mirjana Llazarova Trajkovska - anëtare**
5. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**

**B.II.** Për kryetare të Sektorit të veprave penale caktohet gjyqtarja **Cvetanka Periq**, kurse për zëvendës të saj caktohet gjyqtari **Mr. Safet Kadrii**.

**B.III.** Këshillat prej pesë gjyqtarëve të cilët do të veprojnë për të gjitha llojet e lëndëve në këtë sektor dhe për lëndët sipas Ligjit për drejtësi për fëmijët, janë me këtë përbërje:

1. **Cvetanka Periq – Kryetare**
2. **Dr. Xhemali Saiti - anëtar**
3. **Afrim Fidani - anëtar**
4. **Mirjana Llazarova Trajkovska - anëtare**
5. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**

**B.IV.** Këshillat prej tre gjyqtarëve, Kryetari i këshillit do të formojë nga gjyqtarët të cilët janë caktuar në këshillin prej pesë gjyqtarëve.

**B.V.** Në rast të pengesës dhe shkaqeve të tjera të arsyetuara të kryetarit të këshillit, për zëvendës të kryetarit të këshillit caktohet **gjyqtari Mr. Safet Kadrii**. Për zëvendës të një anëtari të këshillit në rast të pengesës ose për shkaqe tjera të arsyetuara, caktohen gjyqtarët **Jelica Kërstevska, Shpend Devaja dhe Nake Georgieev**.

**B.VI.** Kryetari i Sektorit, përkatësisht Kryetarja e këshillit, gjyqtarja **Cvetanka Periq** nuk obligohet me lëndë.

**B.VII.** Sipas nenit 21 paragrafi (1) të Ligjit për ndjekjen e komunikimeve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.71/18), për gjyqtar që do të vendos për kërkesat e vendimmarrjes me urdhër për ndjekjen e komunikimeve, caktohet **gjyqtarja Besa Ademi**, ndërsa për zëvendëse të saj, **gjyqtarja Cvetanka Periq**.

**B.VIII.** Sipas nenit 21 paragrafi (3) nga ligji i theksuar, formohet këshill prej 3 gjyqtarëve që do të vendos për kundërshtimet e parashtruara kundër njoftimit për mospajtimin nga gjyqtari, me këtë përbërje:

1. **Jelica Kërstevska - kryetare**
2. **Afrim Fidani – anëtar**
3. **Mr. Safet Kadrii - anëtar**

**B.IX.** Në rast të pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara të kryetarit të këshillit, për zëvendës të kryetarit të këshillit caktohet **gjyqtari Mr. Safet Kadrii**, ndërsa për zëvendës të një anëtari të këshillit në rast të pengesës ose për shkaqe tjera arsyetuese, caktohet **gjyqtari Dr. Xhemali Saiti**.

**B.X.** Përgatitja e vendimeve, nënshkrimi, verifikimi dhe ekspedimi i të njëjtave të bëhet në afate të caktuara me ligj dhe në afat të arsyeshëm.

**B.XI.** Ditët për mbajtjen e seancave të këshillave për gjykim të lëndës i cakton kryetari i Sektorit.

### III SEKTORI I VEPRAVE CIVILE

**C.I.** Në Sektorin e veprave civile caktohen gjyqtarët:

1. **Besa Ademi**
2. **Vasil Gërçev**
3. **Vlladimir Stojanoski**
4. **Jelica Kërstevska**
5. **Snezhana Gjorgjieska Zekirija**
6. **Isamedin Limani**
7. **Shpend Devaja**
8. **Nake Georgiev**

**C.II.** Për kryetare të Sektorit të veprave civile caktohet gjyqtarja **Besa Ademi**, ndërsa për zëvendës të kryetares gjyqtari **Shpend Devaja**.

**C.III.** Këshilli i parë prej pesë gjyqtarëve, që do të veprojnë për lëndët Rev1, Rev2 dhe Rev3, do të formohet si në vazhdim:

1. **Snezhana Gjorgjieska Zekirija – kryetare**
2. **Vasil Gërçev - anëtar**
3. **Jelica Kërstevska - anëtare**
4. **Isamedin Limani - anëtar**
5. **Anëtari i pestë në këshillin e parë do të jetë nga dy gjyqtarët e këshillit të dytë që do të rrotojnë sipas vendimit për zgjedhje.**

**C.IV.** Kryetarja e këshillit, gjyqtarja **Snezhana Gjorgjieska Zekirija** nuk obligohet me lëndë.

**C.V.** Këshilli i dytë prej pesë gjyqtarëve që do të veprojnë për lëndët Rev1, Rev2 dhe Rev3, do të formohet si në vazhdim:

1. Shpend Devaja – kryetar
2. Vlladimir Stojanoski – anëtar
3. Nake Georgiev – anëtar
4. anëtar i katërt në këshillin e dytë do të jetë nga tre gjyqtarët e këshillit të parë që do të rrotojnë sipas vendimit për zgjedhje.
5. anëtar i pestë në këshillin e dytë do të jetë nga tre gjyqtarët e këshillit të parë që do të rrotojnë sipas vendimit për zgjedhje.

**C.VI.** Kryetari i këshillit, **gjyqtari Shpend Devaja** nuk obligohet me lëndë.

**C.VII.** Gjyqtarët që do të marrin pjesë si anëtar i pestë në këshillin e parë përkatësisht si anëtar i katërt dhe i pestë në këshillin e dytë nuk do të referojnë lëndë në ato këshilla.

**C.VIII.** Në rast të mungesës dhe pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara kryetarët e këshillave do të zëvendësohen në mënyrë reciproke.

**C.IX.** Kryetarët e këshillave do të formojnë këshillat prej tre gjyqtarëve për procedimin e lëndëve të ndryshme civile “R” nga anëtarët e këshillave të tyre.

**C.X.** Përgatitja e vendimeve, nënshkrimi, verifikimi dhe ekspedimi i të njëjtëve të bëhet në afatet e caktuara me ligj dhe në afat të arsyeshëm.

**C.XI.** Ditët e mbajtjes së seancave të këshillit për gjykim të lëndës i cakton kryetari i Sektorit së bashku me Kryetarët e këshillave.

## **IV**

### **SEKTORI PËR GJYKIM NË AFAT TË ARSYESHËM**

**Ç.I.** Në këtë Sektor caktohen gjyqtarët:

1. Vasil Gërçev
2. Vlladimir Stojanoski
3. Jelica Kërstevska
4. Dr. Xhemali Saiti
5. Snezhana Gjorgjieska Zekirija
6. Isamedin Limani
7. Afrim Fidani
8. Cvetanka Periq
9. Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska
10. Mr. Safet Kadrii
11. Nake Georgiev

**Ç.II.** Për kryetare të Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm caktohet gjyqtarja **Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska**, ndërsa për zëvendëse të saj caktohet gjyqtarja **Snezhana Gjorgjieska Zekirija**.

**Ç.III.** Sekretari i Sektorit dhe zëvendësi sipas nevojës caktohen për punë të lëndëve, me konstatimin e Kryetarëve të këshillave.

**Ç.IV. Këshilli i parë prej tre gjyqtarëve**, që do të vendosin për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në shkallën e parë ëahtë në këtë përbërje:

- 1. Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska - kryetare**
- 2. Mr. Safet Kadrii - anëtar**
- 3. Nake Georgiev - anëtar**

**Ç.V. Këshilli i dytë prej tre gjyqtarëve** për vendimmarrjen e kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm është në këtë përbërje:

- 1. Dr. Xhemali Saiti – kryetar**
- 2. Isamedin Limani - anëtar**
- 3. Afrim Fidani - anëtar**

**Ç.VI.** Kryetarët e këshillave, gjyqtarja **Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska** dhe gjyqtari **Dr. Xhemali Saiti**, nuk obligohen me lëndë.

**Ç.VII.** Në rast të mungesës dhe pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara kryetarët dhe anëtarët do të zëvendësohen në mënyrë reciproke, për zëvendës anëtarë caktohet edhe gjyqtari **Shpend Devaja** ose një gjyqtar tjetër që nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë të procedurës për një lëndë konkrete.

**Ç.VIII.** Gjyqtarët e caktuar në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm do të vendosin për lëndë nga të gjitha materiet.

**Ç. IX.** Për vendimmarrjen e ankesave kundër aktvendimeve të këshillit prej tre anëtarëve për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, caktohet **këshilli prej pesë gjyqtarëve** në këtë përbërje:

- 1. Snezhana Gjorgjieska Zekirija - kryetare**
- 2. Vasil Gërçev - anëtar**
- 3. Vlladimir Stojanoski - anëtar**
- 4. Cvetanka Periq - anëtare**
- 5. Jelica Kërstevksa - anëtare**

**Ç.X.** Kryetarja e këshillit gjyqtarja **Snezhana Gjorgjieska Zekirija** nuk obligohet me lëndë.

**Ç.XI.** Për zëvendës të kryetarit të këshillit caktohet gjyqtari **Vasil Gërçev**.

**Ç.XII.** Në rast të mungesës dhe pengesës për shkaqe tjera të arsyetuara, për zëvendës të një anëtari do të caktohet një gjyqtar tjetër që nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë të procedurës për një lëndë konkrete.

**Ç.XIII.** Përgatitja e vendimeve, nënshkrimi, verifikimi dhe ekspedimi i të njëjtëve të bëhet në afatet e caktuara me ligj dhe në afat të arsyeshëm.

**Ç.XIV.** Ditët e mbajtjes së seancave të këshillit për gjykim të lëndës i cakton kryetari i Sektorit.

## **V KËSHILLAT E SPECIALIZUARA**

**D.I.** Për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të Gjykatës Administrative nga neni 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtje për shkak të veprimit të kundërligjshëm, këshilli prej tre gjyqtarëve është si në vazhdim:

- 1. Afrim Fidani – kryetar**
- 2. Vlladimir Stojanoski - anëtar**
- 3. Jelica Kërstevska - anëtare**

**D.II.** Në rast të mungesës dhe pengesës për shkaqe tjera të arsyetuara të Kryetarit ose një anëtarit të këshillit, për zëvendës të Kryetarit të këshillit përkatësisht një anëtar të këshillit caktohen **gjyqtarët Snezhana Gjorgjieska Zekirija dhe Mr. Safet Kadrii.**

**D.III.** Në pajtim me nenin 49 paragrafi (5) të Ligjit për këshillin gjyqësor, formohet këshill prej pesë gjyqtarëve, që do të vendos për ankesat e kandidatit që nuk është zgjedhur për gjyqtar, si në vazhdim:

- 1. Jelica Krëstevska - Kryetare**
- 2. Vlladimir Stojanoski - anëtar**
- 3. Dr. Xhemali Saiti - anëtar**
- 4. Mr. Safet Kadrii - anëtar**
- 5. Nake Georgiev - anëtar**

**D.IV.** Në rast të mungesës dhe pengesës për shkaqe tjera të arsyetuara të Kryetarit ose një anëtari të këshillit, për zëvendës të Kryetarit të këshillit caktohet **gjyqtarja Cvetanka Periq,** ndërsa për zëvendës të një anëtari të këshillit caktohet **gjyqtari Shpend Devaja.**

## VI SEKTORI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

**DH.I. Në këtë Sektor caktohen gjyqtarët si kryetarë të sektorëve:**

1. **Besa Ademi**
2. **Vasill Gërçev**
3. **Cvetanka Periq**
4. **Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska**

**DH.II.** Për Kryetar të Sektorit të praktikës gjyqësore, caktohet gjyqtari **Vasill Gërçev**, ndërsa për zëvendës të kryetarit gjyqtarja **Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska**.

### A r s y e t i m

Orari vjetor i punës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 është miratuar sipas nenit 88 dhe nenit 39 paragrafi (4) të Ligjit për gjykatat, pas mendimit paraprakisht të siguruar nga Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 21.12.2022.

Orari vjetor është miratuar dhe përshtatur edhe në aspektin e gjendjes me numrin dukshëm të zvogëluar të gjyqtarëve të cilët do të realizojnë funksionin e gjyqtarit në Gjykatën në vitin 2023, deri në zgjedhjen e gjyqtarëve me të cilët do të plotësohen vendet e zbrazura të gjyqtarëve.

Në fakt, Kryetarja e Gjykatës gjatë përgaditjes së Orarit vjetor ka patur parasysh se në fillim të vitit 2023 gjyqtari Mr. Faik Arslani do t'i plotësojë kushtet për pensionim sipas moshës dhe për atë shkak nuk është caktuar në sektor konkret.

Për shkaqet e theksuara u imponua nevoja për angazhimin e disa gjyqtarëve si zëvendës kryetarë dhe anëtarë në këshill, si dhe formimin e këshillave të përkohshme për lëndë konkrete me caktimin e kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave nga rradha e gjyqtarëve që nuk kanë marrë pjesë në asnjë fazë të procedurës.

Sipas ndryshimeve në përbërjen e këshillave, lëndët të cilat u janë dhënë gjyqtarëve me shpërndarjen automatike, ndërsa të njëjtat nuk janë referuar ose nuk është miratuar vendim, automatikisht do të rishpërndahen përmes Programit AKMIS, sipas dispozitave të Rregullores gjyqësore.

Sipas ndryshimeve në përbërjen e këshillave, lëndët që gjenden në punë te gjyqtarët, por janë të referuara ose është miratuar vendim, të përfundohen në të njëjtat këshilla.

Gjatë vitit në qoftë se paraqitet nevoja për rishpërndarjen e lëndëve për shkak të vëllimit të rritur të punës dhe për arsye tjera, ose në rastet nga neni 179 nga Rregullorja gjyqësore, Kryetari i Gjykatës do të miratojë ndryshime dhe plotësime të Orarit vjetor të punës për vitin 2023, që do të jenë pjesë përbërës e të njëjtit.

Ky orar hyn në fuqi nga dita e miratimit, ndërsa do të zbatohet pasi të bëhet i plotfuqishëm.

**KRYETARE  
E GJYKATËS SUPREME TË  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
Besa Ademi**

**UDHËZIM:** Sipas nenit 39 paragrafi (11) të Ligjit për gjykatat, kundër Orarit vjetor të punës, gjyqtari mund të parashtrojë ankesë në afat prej 3-tre ditësh pas pranimit të së njëjtit.

**Dorëzuar:**

- Gjyqtarëve
- Administratorit gjyqësor
- udhëheqësve të sporteleve
- kontabilitetit
- Qendrës IT
- arkivit